

VENDIM
Nr. 38, datë 29.1.2014

**PËR DHËNIEN NË HUAPËRDORJE, PA KUNDËRSHPËRBLIM, NË FAVOR TË BASHKISË
SË KORÇËS, TË NJË SIPËRFAQEJE PREJ 23 000 m² TOKË ARË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 901 e në vijim të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 5 të aktit normativ nr. 4, datë 9.7.2008 të Këshillit të Ministrave “Për privatizimin dhe dhënien në përdorim të shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros së këtyre ndërmarrjeve”, të miratuar me ligjin nr. 9967, datë 24.7.2008, dhe të ligjit nr. 8318, datë 1.4.1998 “Për dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve dhe kullotave që janë pasuri shtetërore”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe të ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien në huapërdorje, pa kundërsHPërblim, në favor të Bashkisë së Korçës, të pasurisë shtetërore nr. 30/2, ZK 8561, vol. 30, f. 70 dhe nr. 31/1, ZK 8561, vol. 30, f. 98, tokë arë, me sipërfaqe të përgjithshme 23 000 m², në qytetin e Korçës, për realizimin e projektit të impiantit fotovoltaiK.

2. Afati i kontratës së huapërdorjes të jetë 30 (tridhjetë) vjet, me të drejtë ripërsëritjeje.

3. Të drejtat dhe detyrimet të përcaktohen në kontratën e huapërdorjes që do të lidhet ndërmjet palëve, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

4. Autorizohet Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave për nënshkrimin e kontratës me Bashkinë e Korçës.

5. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe Bashkia e Korçës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama